

Draft Raporti I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Per aktivitetin:

**“ Impianti I Trajtimit te Ujerave te Ndotura,
Vlore”**

Subjekti: Ujesjelles – Kanalizime, Vlore

Tirane, 2019

➤ **Pershkrimi I aktivitetit**

ITUN Vlorë është projektuar duke pasur parasysh studimet mbi numrin e popullsisë së qytetit të Vlorës, konsumim ditor të ujit për banor dhe sasinë e ndotësve që derdhen në rrjetin e kanalizimeve për banor.

Në hyrje të impiantit është instaluar një zgarë automatike për pastrimin e mbeturinave të ngurta që vijnë në impiant nga rrjeti i kanalizimeve. Pas zgarës, ndodhet dhoma e pompave, ku janë instaluar 4 pompa zhytëse.

Uji i pompuar nga këto pompa kalon në dy zgara më të vogla për eliminimin e mbetjeve më të imta. Pas zgarave ndodhet matësi i fluksit, i cili mat fluksin e prurjeve dhe e dergon këtë të dhënë në sistemin SCADA.

Dhomat e rërës shërbejnë për ndarjen e rërës dhe vajrave nga pjesa tjetër e ujrave të ndotura. Ndarësi i rërës, pasi akumulon rërën, bën të mundur nëpërmjet sistemit të rikthimit, kthimin e ujit për trajtim në impiant. Dhomat e shpërndarjes, të vendosura më tej, bëjnë të mundur dërgimin e ujit në vaskat anareobike.

Për të evituar mbingarkimin e impiantit dhe punimin në përputhje me kushtet e parashikuara në projekt, janë vendosur dy dalje emergjence si menjëherë pas pompave, edhe në fund të dhomave shpërndarëse.

Uji qëndron në vaskat anareobike ku kryhet dhe depozitimi i llumit. Më pas, me anë të dragës, ky llum hidhet në depozitën e llumit. Pjesa e ujit e trajtuar derdhet në fund të vaskave në kanalën e shkarkimit.

Në depozitën e llumit hiqet teprica e ujit dhe rikthehet përsëri për trajtim në impiant. Llumi, nëpërmjet pompës së drenazhit, shpërndahet në shtretërit e tharjes, ku realizohet tharja .

➤ **Kuadri ligjor shqiptar**

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”.*
- *Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhëzim i MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së’*
- *VKM nr. 686 datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.*
- *Ligji 12.2015 date 26.02.2015 ”Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011”Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”.*

Objektivat e VNM-se jane:

- Të japë informacion mbi vendndodhjen e sheshit të projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Të japë informacion mbi projektin teknik për fazën përgatitore, implementimin, marrjen e rezultateve të projektit, punimeve dhe mjeteve që do të përdoren, kompletimin dhe fazën përmbyllëse të tij;
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zones

➤ Pozita gjeografike

Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200,000. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në Detin Adriatik dhe është qendra e Rrethit të Vlorës dhe të Qarkun së Vlorës.

Kushtet klimatike

Klima e Rajonit është tipike mesdhetare me një dimër të lagësht e të ngrohtë dhe me një verë të nxehtë e cila arrin deri në 40 grade. Në përgjithësi në rrethin e Vlores, regjimi i presionit të ulet zgjat pak dhe periudha me kohë të mirë është më e gjatë se në pjesët e tjera të vendit. Faktorët që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

- Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimes.
- Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.
- Larmia e formave të relievit dhe drejtimi i përcaktuar mirë i vargmaleve dhe luginave.

Temperaturat mesatare për Vloren ndryshojnë nga 16,1 në 17,7 grade. Në Vlorë mungojnë temperaturat e uletave që regjistrohen në zonat e tjera të vendit. Temperaturat më të uletave, si në të gjithë zonën bregdetare të Shqipërisë, regjistrohen gjatë Janarit-Shkurtit.

Sasia mesatare e reshjeve arrin 1200mm/vit, pjesa më e madhe e të cilave në nëntor-dhjetor. Muajt më të thatë janë Korriku, Gushti dhe Shtatori. Deti dhe format e relievit ndikojnë shumë në shpërndarjen e reshjeve në rrethin e Vlores. Luginat e Shushicës, Dukatit, Borshit e Vjosës shërbejnë gjatë gjithë vitit si zona të shkëmbimit klimaterik të zonave të bregdetit me ato në brendësi. Kjo është arsyeja e shirave të bollshme pranë zonave malore në krahasim me zonat e tjera të rrethit. Ndërsa në zonën bregdetare të qytetit sasia mesatare e reshjeve është 1000mm/vit e në Orikum 1314mm/vit, në zonat malore si Llogara e Dukatit, reshjet arrijnë përkatesisht 2500 e 2453mm/vit. Numri mesatar i ditëve me lagështi është 105 - 147 ditë në vit. Debora është një dukuri tepër e rrallë në bregdet, ndërsa në zonat malore është një dukuri normale që fillon që në nëntor. Pozicioni gjeografik i rrethit të Vlores bën që zona të jetë nën ndikimin e erërave të fuqishme, që janë të ndryshme për nga forca dhe prania gjatë vitit. Erërat zakonisht janë puhite detare, të cilat ndihen më shumë gjatë bregdetit. Rrethi i Vlores në përgjithësi dallohet për erërat e forta, kjo për shkak të konfigurimit të relievit dhe gjirit të Vlores.

Gjeologjia

Rajoni i Vlores i takon zonës paleogjeografike jonike, e cila në perëndim kufizohet me zonën e Sazanit dhe në lindje me zonën e Krujës. Një njësi e veçantë, më e re se të parat, është ultësira pranadriatike që mbivendoset mbi të tria zonat e lartpërmendura. Zona jonike gjatë zhvillimit të vet paleogjeografik ka qenë një basen detar i thelle nga jorasiku në paleogjen, kurse dy zonat fqinje, Sazani dhe Kruja, kanë qenë basene detare të cekëtta, shpesh të dala dhe mbi ujë.

Në fillim të miocenit të mesëm, rreth 15 milion vjet më parë, zona jonike u përfshi nga proceset e rrudhosjes dhe të malformimit, duke u shndërruar dalëngadalë në stere. Në këtë kohë u formuan disa breza të rrudhosur mbiujorë me pamje antiklinale, si brezi antiklinal i Çikës, ai i Kurveleshit, etj.

Midis tyre mbeten breza nënujore në trajtë sinklinale, si ai i Shushicës, ku vendoset edhe Kuçi, Memaliajt etj. Në fund të miocenit, rreth 5 milion vjet më parë, ndodhi një rrudhosje tepër e fuqishme, që e shndërroi ultësirën pranëadriatike në strere me mjaft rrudha antiklinale e sinklinale.

Flora dhe fauna

Mbulesa bimore e rajonit është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjët dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga : sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja, sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapit. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore.

- ***Kafshe e egra***

Nga kafshët e egra më shumë gjendet derri i egër dhe lepuri, të dëmtuar rëndë nga gjuetia. Haset edhe dhelpira, kunadhja, dreri (sorkadhja) gjendet ne pyllin e

mbrekullueshem te Zarelit si dhe ne pjesen e poshtme te fshatit si ne Shen Thanas, Perroi i Thate etj, shqarthe (macja e eger), lunderza (vidhra) ne lumin Shushice. Nga shpendët përhapje), kukumjaçka (bufi), qyqja, si dhe harabeli, gushkuqi dhe lloje të ndryshme shpendësh. Ne lumin e Shushicës gjenden me shumice trofta, ndërsa ne përrenjtë qe derdhen ne lume ka shume krap te madhësive te vogla, si dhe ngjala. Ne terrenin me shkurre ka zvarranike te përmasave dhe llojeve te ndryshme, te pastuduara ende. Ka gjarpërinj me madhësi edhe mbi 2 merta, ndodhen gjithashtu

edhe nepërka nje gjarpër i rrezikshëm sulmues, astriti dhe gjarpërinj me ngjyra e madhësi te ndryshme. Ne te gjitha pyjet me shkurre te bie ne sy një numër i madh breshkash.

Rrjeti hidrike dhe ujerat

Uji eshte nje pasuri natyrore me vlera te medha kombetare. Ai ka perdorim te madh ne bujqesi, ne industri dhe per furnizimin e qendrave te banuara. Rajoni i Vlores eshte nje rajon bregdetar i cili laget nga deti Adriatik edhe ai Jon, Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lumi i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Por rajoni eshte i pasur edhe me burime ujore , zona e Kuçit ka pasuri të shumta ujërash, si pak fshatra të Kurveleshit ku numërohen rreth 157 burime ujore. Pasuritë më të mëdha janë burimet e Lëpushës me 550 l/s, dhe buronjat e Kuçe me 300 l/s ; një nga burimet më të mëdha karstike të Shqipërisë jugore. Buronjat e Kuçe shkarkojnë ujërat nëntokësore që grumbullohen në masivin karstik të Kurveleshit të Sipërm, i cili gjendet rreth 600 m më lartë se vendi ku dalin Buronjat. Buronjat përfaqësojnë një objekt me rëndësi turistike për gjithë rajonin.

➤ Ndikimet negative ne mjedis

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- Pastrimi i ambjenteve te aktivitetit
- Ujerat e perdorura per qellime sanitare.

Keto ujera shkarkohen ne vete impiantin e trajtimit te ujerave te ndotura urbane, bashke me ujerat e ndotura urbane te qytetit te Vlores. Pasi i nenshtrohen procesit te trajtimit, ato derdhen ne rrjedhen ujore brenda normave te lejuara .

Ndotja e tokes

Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk kemi ndikime ne toke. Procesi I trajtimit te ujerave te ndotura urbane nuk ka ndikime ne toke pasi te gjitha njesite e impiantit jane te izoluara nga toka. Nga ky aktiviteti gjenerohet nje sasi mbetjesh metalesh te cilat subjekti do te gjeje menyren e largimit te tyre per ne vendgrumbullimet e asgjesimit perfundimtar te tyre. Në depozitën e llumit hiqet teprica e

ujit dhe rikthehet përsëri për trajtim në impiant. Llumi, nëpërmjet pompës së drenazhit, shpërndahet në shtretërit e tharjes, ku realizohet tharja .

Ndotja e ajrit

Nga zhvillimi I ketij aktiviteti nuk kemi ndikime ne ajer.

Ndikimet ne klime

Gjate zhvillimit te projektit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

Ndikimet nga zhurmat dhe vibracionet

Zhurmat qe prodhohen ne kete aktivitet vijne kryesisht nga makinerite dhe pjeset perberese te impiantit. Punonjesit qe do te punojne ne kete aktivitet, ne zona pune qe do te kete nivel te larte emtimi zhurme, punonjesit vazhdimisht do te perdorin kufje mbrojtese.

Ndikimi ne mjedisin social

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social eshte pozitiv persa i perket punesimit te banoreve te qytetit te Vlores si edhe ne permiresimin e kushteve te mjedisit pasi behet trajtimi i ujerave te ndotura dhe derdhen brenda normave te lejuara .

Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazh

Projekti nuk ka ndikime negative ne zonen rrethuese. Zbatimi i projektit nuk ndryshon konfiguracionin, topografine e zones dhe pejsazhin e saj. Prandaj nuk dote kete nevoje per reabilitime te dukshme.

Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga zhvillimi i projektit gjate fazës normale te operimit

Gjate fazes normale te zbatimit te projektit, bazuar ne teknologjine e perdorur nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve te ngurta toksike dhe lende te tjera te demshme qe mund te shkarkohen ne ajer dhe ne toke, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e puntoreve, banoreve per rreth, mjedisin floren dhe faunen e zones.

Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerëzore

Nga zbatimi i projektit nuk ka dhe nuk do të ketë impakt negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerëzore, sepse në këto zone dhe për rreth saj, nuk ka objekte të kësaj natyre ose të një rëndësie të veçantë të karakterit të mesiperm.

➤ Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Kerkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësive e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave të gjelberuara. Drejtues të subjektit i cili do të vihet në shfrytëzim, do të marrin në konsideratë të gjitha masat lehtësuese zbutëse për ndikimet në mjedis.

Masat për ndikimet nga zhurmat

Në zonën e aktivitetit, subjekti do të hartojë dhe zbatojë programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat, si më poshtë:

- a. Do të respektohen standardet për nivelin e zhurmave;
- b. Aktivitetet e punës do të kufizohen në orët që sjellin shqetësime për banorët përreth;
- c. Makineritë e pjesët perberëse të impiantit, si dhe ato që gjenerojnë zhurmë mbi kufijtë e lejuar, do të jenë të pajisura me ekrane mbrojtëse për zhurmat.

Masat për ndikimet në ajër

Me qëllim që shkarkimet në ajër që emetohen do të jenë vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjekti, do të marrë marrin këto masa:

- a. Për lëvizjen e mjeteve në impiant do të respektohet një shpejtësi e ulët e lëvizjes së mjeteve me qëllim shmangien e emetimit të pluhurave në ajër.

- b. Te gjitha rruget perreth impiantit jane te shtruara me asfalt me qellim shmangien e emetimit te pluhurave ne ajer

Masat per ndikime ne toke

Nuk do te kemi ndikime ne toke, pasi skemi shkarmike te mbetjeve ne toke. Mbetjet urbane e gjeneruara nga stafi i punonjesve do te dergohen per ne vendet e percaktuara nga pushteti lokal.

Masat per ndikimet ne ujera

Nuk do e kete ndikime negative ne ujera.

➤ PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum perdorimi i gjeneratorit dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane .
- Të vendosen postera sensibilizues per punonjesit dhe banoret per nje mjedis te paster.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset dhe të ndërtohen shkallët e emergjencës.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.